



# **GJENDJA FINANCIARE DHE HUAMARRJA E FAMILJEVE NË SHQIPËRI**

**Gjashtëmuji i dytë 2022**

**BANKA E SHQIPËRISË  
DEPARTAMENTI I STABILITETIT FINANCIAR**

**Shkurt 2023**

## PERMBAJTJA

1 -Karakteristikat demografike dhe financiare të familjeve të intervistuar.....	4
2- Huamarrja e familjeve .....	6
3- Ngarkesa në borxh e familjeve.....	11
4- Pasuria e familjeve .....	13

## Përmbledhje e gjetjeve kryesore të Vrojtimit mbi Gjendjen Financiare dhe

### Huamarrjen e Familjeve

*Nga rezultatet e vrojtimit vihet re se totali i të punësuarve në kampionin e vrojtuar ka shënuar rënie gjatë periudhës, e ardhur kryesisht nga sektori shtetëror. Pësha e familjeve huamarrëse ndaj totalit dhe teprica e huasë së deklaruar kanë rezultuar në rritje. Pjesa më e madhe e huamarrjes ka për qëllim blerjen/riparimin e një prone dhe zhvillimin e një biznesi. Familjet parashikojnë rënie të aftësisë së tyre paguese në gjashtë muajt e ardhshëm, ndërsa kërkesa për huamarrje pritet të tkurret, ndikuar nga rritja e normave të interesit.*

#### ▪ GJENDJA FINANCIARE

Numri total i të punësuarve në kampionin e vrojtuar ka shënuar rënie me 3.4% krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe me 6.8% krahasuar me një vit më parë. Në terma vjetorë, rënia ka ardhur nga sektori shtetëror dhe sektori i të vetëpunësuarve, ndërkohë që numri i të punësuarve në sektorin privat është rritur me 6%. Niveli i përgjithshëm i të ardhurave dhe shpenzimeve të familjeve ka shënuar rritje si në terma gjashtëmujorë dhe vjetorë.

#### ▪ HUAMARRJA

Rreth 26% e familjeve që janë përgjigjur (ose 275 familje), deklarojnë se kanë hua për të paguar në momentin e intervistimit. Kjo peshë është rritur me 4 pp në terma gjashtëmujorë dhe me 2 pp në terma vjetorë. *Totali i tepricës së raportuar të huasë ka rezultuar në rritje krahasuar me vrojtimin e kaluar dhe me një vit më parë.* Rreth 52% e kësaj teprice është siguruar nga "burime formale" ("bankat" dhe "IFJB") dhe 48% nga "burime joformale" ("persona fizikë" dhe "hua në formë malli"). Kjo strukturë është zhvendosur në favor të kësaj të fundit, si rezultat i rritjes së huamarrjes nga personat fizikë kundrejt rritjes së huamarrjes nga bankat dhe rënies së huamarrjes nga IFJB-të. Sipas qëllimit të përdorimit, rreth 40% e tepricës është përdorur për "blerjen/riparimin e një prone"; 26% për "zhvillimin e një biznesi"; 3% për qëllime "konsumi"; dhe 31% për "qëllime të tjera" (ku mbizotëron huamarrja për të mbuluar shpenzimet shëndetësore).

#### ▪ NGARKESA NË BORXH

Rreth 72% e familjeve huamarrëse deklarojnë që kësti i huasë nuk ka ndryshuar gjatë periudhës, ndërsa balanca neto e pjesës tjetër të përgjigjeve tregon për rritje të këstit të huasë, ndikuar nga rritja e normave të interesit në vend. Për gjashtëmujorin e parë të vitit 2023, rreth 62% e familjeve nuk presin ndryshim të aftësisë së tyre paguese, ndërsa balanca neto e pjesës tjetër të përgjigjeve sugjeron për pritje pesimiste krahasuar me rezultatet e gjashtëmujorit të kaluar dhe të një viti më parë. Indeksi i marrjes/rimarrjes së një huaje në 6 muajt e ardhshëm ka shënuar rënie në terma gjashtëmujorë dhe vjetorë, duke sinjalizuar ngadalësim të kërkesës së individëve për financim. Kjo është e pritshme në kushtet e rritjes së normave të interesit të huave, si rezultat i normalizimit të politikës monetare në vend.

#### ▪ PASURIA E FAMILJEVE

Rreth 94% e familjeve (total i kampionit të intervistuar) "zotërojnë 1-2 prona të patundshme", kryesisht shtëpi banimi dhe kjo peshë ka shënuar një rënie të lehtë me 1 pp, krahasuar respektivisht me vrojtimin e kaluar dhe me një vit më parë; 3% deklarojnë se "zotërojnë më shumë se 2 prona të patundshme" (shtëpi dhe tokë/dyqan etj.), dhe 6% kanë deklaruar se "nuk zotërojnë asnjë pronë". Në grupin e familjeve që zotërojnë pasuri financiare, rezulton se "depozitat/llogaritë bankare" mbeten lloji kryesor i investimit financiar, si në rastin e totalit të kampionit të familjeve (71% e rasteve të raportuara) dhe në rastin e familjeve huamarrëse (79% e rasteve të raportuara). Krahasuar me periudhën paraardhëse, këto pësha janë rritur ndjeshëm.


# 1 -Karakteristikat demografike dhe financiare të familjeve të intervistuar

**Karakteristikat e kampionit.** Vrojtimi i radhës është kryer mbi kampionin rastësor prej 1205 familjesh, ku rreth 89% e tyre (1068 familje) kanë marrë pjesë në procesin e intervistimit duke iu përgjigjur plotësisht ose pjesërisht pyetjeve të pyetësorit. Pësia e atyre që janë përgjigjur ndaj totalit të kampionit është rritur me 1 pp krahasuar me vrojtimin e kaluar dhe me një vit më parë. Në totalin e familjeve që janë përgjigjur, rezulton se rreth 53% e tyre banojnë në zonat urbane dhe 47% në zonat rurale të vendit.

Analiza në vijim i referohet vetëm familjeve që kanë dhënë përgjigje për secilën pyetje dhe të gjitha llogaritjet janë bërë mbi bazën e totalit të të përgjigurve.

**1.1 Punësimi dhe burime të tjera të ardhurash.** Numri total i anëtarëve të familjeve që sigurojnë të ardhura nga punësimi/vetëpunësimi në sektor shtetëror, privat dhe/ose burime të tjera<sup>1</sup>, ka shënuar rënie krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar (me 1.5 %) dhe krahasuar me një vit më parë (me 2.8%), më e theksuar në rastin e të punësuarve në sektorin shtetëror dhe të vetëpunësuarve.

**Grafik 1.1 Shpërndarja e personave që sigurojnë të ardhura sipas llojit të burimit**  
(në % ndaj totalit të personave që sigurojnë të ardhura)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shënim: Zëri "Tjetër" përmblendh kryesisht rastet e personave që marrin asistencë invaliditeti, ndihmë nga të afërm dhe ata që bëjnë punë të rastit.

Duke e fokusuar analizën vetëm në pjesën e të punësuarve<sup>2</sup> të kampionit të vrojtuar (Tabelë 1.1), numri total i tyre gjithashtu ka shënuar rënie me 3.4% në terma gjashtëmujorë dhe me 6.8% në terma vjetorë. Në terma vjetorë, rënia ka ardhur nga sektori shtetëror (me 15%) dhe sektori i të vetëpunësuarve (me 17%), ndërkohë që numri i të punësuarve në sektorin privat ka shënuar rritje me 6%.

<sup>1</sup>Në pyetësor, përveç punësimin në sektor shtetëror dhe privat, si burime të ardhurash listohen dhe: "pensioni", "asistenca sociale për papunësi", "emigracioni" dhe zëri "tjetër", ku përfshihet çdo lloj burimi tjetër që nuk është marrë parasysh në alternativat e dhëna.

<sup>2</sup>Këtu janë përfshirë vetëm të punësuarit në sektorët shtetërorë, privat (bujqësor dhe jobujqësor) dhe të vetëpunësuar (në sektor bujqësor dhe jobujqësor).

**Tabelë 1.1 Numri i të punësuarve sipas sektorëve**

		Shtetëror	Privat	Vetëpunësuar	Total të punësuar	Ndr. 6-mujor	Ndr. vjetor
V15	6MII_2017	317 (21%)	595 (38%)	634 (41%)	1546	-2.2%	2.1%
V16	6MI_2018	259 (17%)	592(38%)	705 (45%)	1556	0.6%	-1.5%
V17	6MII_2018	280 (18%)	618(39%)	682 (43%)	1580	1.5%	2.2%
V18	6MI_2019	266 (18%)	623 (41%)	613 (41%)	1502	-4.9%	-3.5%
V19	6MII_2019	235 (17%)	574 (41%)	606 (43%)	1415	-5.8%	-10.4%
V20	6MI_2020	233 (16%)	621 (43%)	585 (41%)	1439	1.7%	-4.2%
V21	6MII_2020	234 (16%)	578 (41%)	611 (43%)	1423	-1.1%	0.6%
V22	6MI_2021	241 (17%)	670 (46%)	532 (37%)	1443	1.4%	0.3%
V23	6MII_2021	231 (16%)	642 (44%)	602 (41%)	1475	2.2%	3.7%
V24	6MI_2022	234 (16%)	639 (45%)	550 (39%)	1423	-3.5%	-1.4%
V25	6MII_2022	197 (14%)	679 (49%)	499 (36%)	1375	-3.4%	-6.8%


Burimi: Departamenti i Stabilitetit Financiar.

Shënim: Shifrat në kllapa janë peshat e secilit zë në raport me totalin e të punësuarve.

Numri i familjeve që kanë deklaruar dhe **burime të tjera të qëndrueshme të ardhurash**<sup>3</sup> (si qira, interesa bankare etj.) ka rezultuar 14% (ose gjithsej 147 familje), duke shënuar rritje të lehtë me 2 pp gjatë periudhës dhe me 2.4 pp krahasuar me një vit më parë. Në këtë grup familjesh, rreth 48% e tyre deklarojnë si burime alternative të ardhurash “*interesat nga kursimet (depozita, bono thesari etj.)*”, ndërsa rreth 20% deklarojnë të ardhura nga “*qiradhënia e pronave*”. Një peshë të konsiderueshme (rreth 30%) ka vijuar të shënojë zëri “tjetër”, ku familjet përmendin si burim të ardhurash kryesisht ndihmën nga familjarë ose të afërm.


**1.2 Të ardhurat dhe shpenzimet e familjeve.** Gjatë 6-mujorit në analizë, pjesa më e madhe e familjeve (rreth 47%) vijnë të deklarojnë të ardhura mujore në nivelin “17-50 mijë lekë”, por kjo peshë ka rënë me 5 pp krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe me 7 pp krahasuar me një vit më parë (Grafik 1.2). Nga ana tjetër, struktura e shpërndarjes së familjeve sipas *niveleit të të ardhurave mujore*, duket se ka vijuar të zhvendoset drejt niveleve më të larta si “50-100 mijë” (35% të familjeve) dhe “100-200 mijë” (9% e familjeve).

**Grafik 1.2 Shpërndarja e familjeve sipas nivelit mujor të të ardhurave**



Burimi: Banka e Shqipërisë.

**Grafik 1.3 Shpërndarja e familjeve sipas nivelit mujor të shpenzimeve**




<sup>3</sup> Në këtë pyetje, alternativat e listuara si burime të qëndrueshme të ardhurash janë: (1) qira, (2) interesa nga kursimet (depozita, bono thesari etj.), (3) interesa nga para të dhëna hua të tretëve, (4) tjetër (përcakto).

Në shpërndarjen e familjeve sipas nivelit të shpenzimeve të domosdoshme të jetesës, gjatë periudhës vihet re një zhvendosje e strukturës drejt dy niveleve më të larta të shpenzimeve mujore (“50 mijë-10 mijë lekë” dhe “mbi 100 lekë në muaj”), duke reflektuar në këtë mënyrë rritjen e kostos së jetesës së familjeve për shkak të rritjes së përgjithshme të çmimeve në vend (Grafik 1.3).

Në bazë të përgjigjeve të mësipërme, rezulton se **Indeksi i të ardhurave**<sup>4</sup> dhe **Indeksi i shpenzimeve**<sup>5</sup> kanë shënuar rritje gjatë periudhës, ku rritja e indeksit të të ardhurave ka qenë disi më e theksuar.

**Grafik 1.4 Indekset e të ardhurave dhe shpenzimeve të familjeve (2010=100)**



Burimi: Banka e Shqipërisë.

*Euroizimi i të ardhurave* të familjeve shqiptare vijon të mbetet i ulët, por ka shënuar një prirje rritëse gjatë periudhës. Kështu rreth 20% familjeve (221 familje nga 1069 familje nga të përgjigjura) deklarojnë se kanë të ardhura në valutë (kryesisht në euro) në raporte të ndryshme ndaj totalit të të ardhurave mujore<sup>6</sup> dhe kjo peshë është rritur respektivisht me 3 pp krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe me një vit më parë.

## 2- Huamarrja e familjeve

Në këtë vërtetim, numri i familjeve që deklarojnë se kanë një ose më shumë hua për të paguar në momentin e intervistimit, pavarësisht llojit, burimit apo vlerës së kësaj huaje, ka rezultuar në 275 familje ose rreth 26% e

<sup>4</sup> “Indeksi i të ardhurave” është ndërtuar si shumë e peshuar e frekuencave në % të përgjigjeve me koeficientët e përcaktuar për çdo interval si në vijim: “deri në 17 mijë lekë” me 0.2; “17-50 mijë lekë” me 0.4; “50-100 mijë lekë” me 0.6; “100-200 mijë lekë” me 0.8; dhe “mbi 200 mijë lekë” me 1. Vlerat e marra për çdo vit janë kthyer në indeks me bazë vitin 2010 = 100. Rritja e vlerës së indeksit nënkupton rritje të nivelit të të ardhurave mujore.


<sup>5</sup> ‘Indeksi i shpenzimeve’ është ndërtuar si shumë e peshuar e frekuencave në % të përgjigjeve me koeficientët e përcaktuar për çdo interval si në vijim: “deri në 10 mijë lekë” me 0.2; “10-20 mijë lekë” me 0.4; “20-50 mijë lekë” me 0.6; “50-100 mijë lekë” me 0.8” dhe “mbi 100 mijë lekë” me 1. Vlerat e marra për çdo vit janë kthyer në indeks me bazë vitin 2010 =100. Rritja e vlerës së indeksit nënkupton rritje të nivelit të shpenzimeve të domosdoshme mujore.

<sup>6</sup> Alternativat e lidhur me nivelin e të ardhurave në monedha të huaja janë: (1) “nuk kam fare”, (2) “deri në 10%”, (3) “10-50%” dhe (4) “mbi 50%”.

atyre që janë përgjigjur (Grafik 2.1). Kjo peshë ka rezultuar në rritje me 4 pp krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe 2 pp krahasuar me një vit më parë, duke vijuar të mbetet nën mesataren historike të vërtetimit prej rreth 27%. Analiza në vijim i referohet vetëm grupit të familjeve huamarrëse<sup>7</sup>.

**2.1 Niveli i të ardhurave dhe shpenzimeve të familjeve huamarrëse.** Gjatë gjashtëmujorit të vërtetuar, sikurse në rastin e totalit të kampionit, struktura e shpërndarjes së familjeve huamarrëse sipas të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruara, është zhvendosur drejt niveleve më të larta krahasuar me periudhën e kaluar. Kjo zhvendosje ka qenë më e theksuar në rastin e të ardhurave, duke sjellë një rritje më të shpejtë të indeksit të të ardhurave krahasuar me rritjen e indeksit të shpenzimeve (Grafik 2.2).

**Grafik 2.1 Indeksi i të ardhurave dhe shpenzimeve të familjes huamarrëse**  
(2010 = 100)




Burimi: Banka e Shqipërisë.

**2.2 Qëllimi i huamarrjes.** Qëllimi kryesor i huamarrjes mbetet: “për konsum” në 36% të rasteve të huamarrjes, “për blerjen/riparimin e një prone” në 20% të rasteve dhe për “zhvillim biznesi” në 11% të rasteve. Peshat e rasteve të huamarrjes “për blerje/riparim prone” dhe “për zhvillim biznesi” kanë rezultuar në rënie krahasuar me 6-mujorin e kaluar (respektivisht me 4 pp) dhe krahasuar me një vit më parë (respektivisht me 5 pp dhe 1 pp). Nga ana tjetër, rastet e huamarrjes për “konsum”, kanë shënuar rritje me 3 pp në terma 6-mujorë dhe me 1 pp në terma vjetorë, gjë që mund të jetë ndikuar dhe nga rritja e kostos së jetesës së familjeve për shkak të rritjes së ndjeshme të çmimeve në vend.

<sup>7</sup> Shënim metodologjik: meqë një familje mund të ketë më shumë se një hua për të paguar në periudhën referuese me karakteristika të ndryshme (burimi, qëllimi etj.), për të mos humbur informacionin, në këtë rubrikë, llogaritjet janë bërë mbi “totalin e rasteve të huamarrjes” të deklaruara, përveçse kur specifikohet “...mbi totalin e huamarrësve (në këtë vërtetim = 257 familje). Me “raste huamarrjeje” nënkuptojmë totalin e huave të marra nga e njëjta familje dhe me të njëjtën karakteristikë p.sh.: një familje që deklaron 2 hua të marra nga banka përbën “1 rast huamarrje nga banka” dhe një familje që ka një hua nga banka dhe një nga një person fizik, përbën “1 rast huamarrjeje nga banka” dhe “1 rast huamarrjeje nga persona fizikë”.

### Grafik 2.2 Huamarrja sipas QËLLIMIT të përdorimit të huasë


(në % ndaj totali të rasteve të huamarrjes)



Burimi: Banka e Shqipërisë.


**2.3 Teprica e huasë.** Duke analizuar tepricën e deklaruar sipas burimeve dhe qëllimeve të përdorimit, rezultoi se për gjashtëmujorin në analizë, rreth 52% e tepricës vjen nga burime formale (51% nga bankat dhe 1% nga IFJB-të) dhe rreth 48% nga burime joformale (47% në formën e huamarrjes nga “persona fizikë” dhe 1% si “hua në formë malli të papaguar”). Kjo strukturë është zhvendosur në favor të huamarrjes nga burime joformale kundrejt asaj formale, si në terma gjashtëmujorë (me 14 pp) dhe në terma vjetorë (me 27 pp). Kjo ka ardhur si rezultat i rritjes më të madhe të vlerës së huamarrjes nga personat fizikë kundrejt rritjes së huamarrjes nga bankat dhe rënies së huamarrjes nga IFJB (Grafik 2.3).

### Grafik 2.3 Përbërja e tepricës sipas BURIMIT të huasë (në % ndaj totalit të tepricës së deklaruar)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

### Grafik 2.4 Përbërja e tepricës sipas QËLLIMIT të huasë (në % ndaj totalit të tepricës së deklaruar)



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Shënim: Zëri “Të tjera” përfshin kryesisht huamarrje për të përballuar shpenzime mjekësore.



Duke e analizuar tepricën e huamarrjes sipas qëllimit të përdorimit (Grafik 2.4), rezulton se rreth 40% e saj është përdorur për *“blerjen/riparimin e një prone”* (1 pp më e ulët se gjashtëmujorin e kaluar, por gjithsesi 12 pp më e lartë se një vit më parë); 26% për *“zhvillim biznesi”* (në rritje me 14 pp krahasuar 6MI 2002, por 33 pp më e ulët se një vit më parë) dhe 3% për *“konsum”* (në rënie me 6 pp respektivisht krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe me një vit më parë). Një peshë të konsiderueshme vijon të ketë huamarrja për *“qëllime të tjera”* (rreth 31% e tepricës), ku mbizotëron huamarrja për mbulimin e *“shpenzimeve shëndetësore”*.

**2.4 Format e huamarrjes.** Në rreth 34% të rasteve të raportuara, huamarrja e familjeve rezulton në formën e *“kredisë nga institucione financiare”*, ku 27% e rasteve janë në trajtë *“kredie bankare”* (rënie 4 pp krahasuar me 6MI 2022 dhe e pandryshuar krahasuar me një vit më parë) dhe 7% janë në trajtë *“kartash krediti dhe overdraft”* (rritje me 4 pp krahasuar me 6MI 2022 dhe rritje me 3 pp referuar një viti më parë). Në rreth 47% të rasteve, huamarrja deklarohet në formën e *“parasë në dorë”* dhe në 19% të rasteve në formë *“malli të papaguar”*. Në rastin e parë, pesha ka rezultuar në rënie me 2pp dhe 4 pp respektivisht në terma gjashtëmujorë dhe vjetorë, ndërsa në rastin e dytë ka qenë në rritje me 2 pp dhe 1pp.

**Grafik 2.5 - Huamarrja sipas FORMËS së huasë**  
(në % ndaj totalit të rasteve të huamarrjes)




Burimi: Banka e Shqipërisë.

**2.5 Paguesa e huasë.** Dy format kryesore të pagesës së huasë vijnë të mbeten pagesat *“me shumë të njëjta çdo 1/3/6/12 muaj”* (40% e rasteve të huamarrjes), *“me shumë të ndryshueshme në periudha të ndryshme”* (33% e rasteve të huamarrjes) dhe me *“shuma të ndryshueshme çdo 1/3/6/12 muaj”* (14% e rasteve të huamarrjes) (Grafik 2.8). Gjatë gjashtëmujorit në analizë, vihet re një rritje (respektivisht me 1 pp dhe 5 pp) e peshës së huamarrjes që paguhet rregullisht me shumën të njëjta (ose të ndryshueshme) çdo muaj, tipike e kredimarrjes bankare afatgjatë (si p.sh. kredimarrja për blerje shtëpie ose zhvillim biznesi). Nga ana tjetër, pesha e rasteve të huamarrjes që shlyhet me *“një shumë në fund të periudhës”* dhe me *“shuma të ndryshme në periudha të ndryshme”*, karakteristike e huave joformale apo huave bankare afatshkurtra (si overdraft, kartë krediti etj.), ka rezultuar në rënie (respektivisht me 3 pp) në terma 6-mujorë dhe në rënie (respektivisht me 2pp dhe 1 pp) në terma vjetorë.

## Grafik 2.6 Huamarrja sipas MËNYRAVE TË PAGESËS

(në % ndaj totalit të rasteve të huamarrjes)




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Përsa i përket ngarkesës së huasë ndaj të ardhurave të familjeve huamarrëse, rezultojnë se rreth 71% e tyre deklarojnë që kjo pagesë zë më pak se 30% të të ardhurave mujore ("deri në 10% të të ardhurave" për 26% të familjeve huamarrëse, "10-30% të të ardhurave" për 46% të familjeve huamarrëse) dhe kjo peshë ka rënë me 3 pp në terma gjashtëmujorë dhe me 9 pp në terma vjetorë. Nga ana tjetër, rreth 29% të familjeve deklarojnë se kjo pagesë e tejkalon 30% të të ardhurave ("31-50% të të ardhurave" për 20% të familjeve, "51-70%" për 5% të familjeve dhe "mbi 70%" për 4% të familjeve) (Grafik 2.9).

## Grafik 2.7 Huamarrja sipas raportit "kësti i huasë/të ardhurat totale mujore"


(në % ndaj totalit të rasteve të huamarrjes)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

**2.6 Afati i mbetur deri në maturim.** Në 64% të rasteve të huamarrjes deklarohet se huaja maturohet "brenda një viti" dhe kjo peshë ka rënë me 8 pp krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe me 4 pp krahasuar me një vit më parë; në 32% të rasteve, afati i mbetur është "1-5 vjet" (në rritje me 7 pp dhe 4 pp krahasuar respektivisht me 6MI 2022 dhe me 6MII 2021) dhe në 5% të rasteve ka rezultuar "mbi 5 vjet" (në rritje me 1 pp krahasuar me 6MI 2022 dhe i pandryshuar krahasuar me një vit më parë).


**Grafik 2.8 Huamarrja sipas MATURIMIT TË MBETUR të huasë**  
(në % ndaj totalit të rasteve të huamarrjes)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

**2.7 Garantimi i huamarrjes.** Në 68% të rasteve të huamarrjes rezulton se huaja është “e pa garantuar” dhe kjo peshë ka rënë me 2 pp krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar, por me 1 pp krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Nga ana tjetër, pesha e rasteve të huamarrjes së garantuar “me një pronë të familjes” ka rezultuar në rritje me 2 pp në terma gjashtëmujorë dhe vjetorë.

**Grafik 2.9 Huamarrja sipas FORMAVE TË GARANTIMIT të huasë**  
(në % ndaj totalit të rasteve të huamarrjes)



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Shënim: Zëri “tjetër” përmbledh rastet e huamarrjes së garantuar me forma të tjera, ku më shpesh përmendet garantimi i huasë përmes pagës, garantimi me një mall (si makina) etj.

### 3- Ngarkesa në borxh e familjeve

Në këtë seksion pyetjesh, familjeve huamarrëse u kërkohet të japin informacion vetëm për *huanë më të madhe* ekzistuese dhe që rëndon më shumë mbi ekonominë e familjes. Si rrjedhojë, peshat e përgjigjeve janë llogaritur mbi totalin e familjeve huamarrëse që janë përgjigjur për secilën pyetje.

**3.1 Ndryshimi i këstit.** Rreth 72% e familjeve huamarrëse që janë përgjigjur kanë deklaruar se kësti i huasë (ose huasë më të madhe në rast se kanë më shumë se një) ka mbetur i pandryshuar gjatë gjashtëmujorit referues, por kjo peshë ka rënë me 5 pp në terma gjashtëmujorë dhe me 3 pp në terma vjetorë. Nga ana tjetër, numri i familjeve që kanë deklaruar “*rritje të këstit*” ka tejkaluar numrin e atyre që kanë deklaruar “*rënie të tij*”, duke rezultuar në një *balancë neto* të përgjigjeve prej +4.7 pp. Kjo balancë ka rezultuar në rritje si krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe një vit më parë, ndikuar nga rritja e përgjithshme e normave të interesave në vend gjatë periudhës.

**Grafik 3.1 Ndryshimi i këstit mujor të huasë në 6 muajt e kaluar**




Burimi: Banka e Shqipërisë.

**3.2 Aftësia paguese në 6 muajt e kaluar dhe pritshmëritë për 6 muajt e ardhshëm.** Rreth 47% e familjeve huamarrëse kanë deklaruar se aftësia e tyre paguese “*nuk ka ndryshuar*” gjatë periudhës së vrojtuar, por kjo peshë ka rënë me 4 pp krahasuar me gjashtëmujorin paraardhës dhe me 3 pp krahasuar me një vit më parë. Pjesa tjetër e atyre që janë përgjigjur, vlerësojnë në agregat *përkeqësim të aftësisë së tyre paguese* (ku 47% kanë deklaruar “*përkeqësim*” dhe 6% kanë deklaruar “*përmirësim*”), duke rezultuar në një *balancë neto* prej -41.2 pp, në thellim krahasuar me periudhat paraardhëse (Grafik 3.2).


Ky perceptim është reflektuar dhe në përkeqësim të pritjeve të familjeve lidhur me aftësinë e tyre paguese gjatë gjysmës së parë të vitit 2023. Kështu, rreth 62% e familjeve huamarrëse *nuk presin ndryshim të aftësisë së tyre paguese për gjysmën e parë të këtij viti*, ndërsa balanca neto e përgjigjeve të pjesës tjetër ka rezultuar – 21.5 pp, duke sugjeruar për pritje pesimiste krahasuar me rezultatet e gjashtëmujorit të kaluar dhe të një viti më parë (Grafik 3.3).

**Grafik 3.2 Aftësia paguese në 6 muajt e kaluar**



Burimi: Banka e Shqipërisë.


**Grafik 3.3 Pritshmëritë për aftësinë paguese në 6 muajt e ardhshëm**



**3.3 Pritshmëritë mbi marrjen e një huaje të re në 6 muajt e ardhshëm**<sup>8</sup>. Rreth 56% e të intervistuarve që janë përgjigjur kanë deklaruar se “nuk presin të marrin hua të re në 6 muajt e ardhshëm”, ndërsa rreth 44% e tyre (ose 467 familje), deklarojnë se e konsiderojnë mundësinë (në shkallë të ndryshme sigurie<sup>9</sup>) për të marrë/rimarrë një hua të re. Përsa a familjeve që e konsiderojnë marrjen e një huaje, ka rënë me 3 pp krahasuar me gjashtëmujorin kaluar dhe me 1 pp krahasuar me një vit më parë. Duke analizuar vetëm grupin e familjeve që planifikojnë të marrin një hua të re (467 familje), rezulton se rreth 55% e tyre janë “huamarrës të rinj”, pra që nuk kanë hua të papaguar në momentin e intervistimit dhe kjo peshë ka rënë si në terma gjashtëmujorë (me 5 pp) dhe në terma vjetorë (me 4 pp).

Si rezultat i shpërndarjeve të mësipërme, *indeksi i mundësisë për të rimarrë një hua të re*<sup>10</sup> ka rezultuar 0.188, duke shënuar rënie krahasuar me periudhën e kaluar dhe një vit më parë, gjë që mund të sinjalizojë një ngadalësim të kërkesës së individëve për kredi në gjysmën e parë të vitit 2023. Këto zhvillime janë të pritshme në kushtet e rritjes së normave të kredisë si rezultat i normalizimit të politikës monetare në vend, dhe pasigurisë mbi dinamikat e ardhshme të çmimeve.

**Grafik 3.4 Familjet që planifikojnë të marrin hua në 6 muajt e ardhshëm dhe indeksi i planifikimit**



Burimi: Banka e Shqipërisë.

## 4 Pasuria e familjeve

Kjo rubrikë përmban vetëm 2 pyetje mbi pronat e patundshme dhe pasurinë financiare të familjeve të intervistuar dhe i drejtohet të gjithë kampionit të familjeve. Rezultatet për 6-mujorin e dytë të vitit 2022, paraqiten si më poshtë:

**4.1 Pasuritë e patundshme të familjeve.** Për këtë seksion pyetjesh kanë dhënë përgjigje 1005 familje, nga të cilat 94% kanë deklaruar se zotërojnë të paktën një pronë të patundshme dhe kjo peshë ka rënë me 1 pp respektivisht krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe krahasuar me një vit më parë. Familjet që janë

<sup>8</sup> Pyetja i drejtohet të gjithë kampionit prej 1210 familjesh dhe asaj i janë përgjigjur 1083 familje ose rreth 90% e totalit të kampionit.

<sup>9</sup> Alternativat e dhëna janë: ‘ka pak mundësi’, ‘ka shumë mundësi’ dhe ‘është e sigurt’.


<sup>10</sup> Indeksi është llogaritur si mesatare e peshuar e % së përgjigjeve për secilën alternativë me koeficientet përkatës. Për përcaktimin e koeficientëve, intervali 0-1 është ndarë në 4 nën-intervale me gjatësi të barabartë 0.33. Koeficientët për secilën alternativë rezultojnë: 0(‘nuk ka asnjë mundësi’), 0.33 (‘ka pak mundësi’), 0.66 (‘ka shumë mundësi’) dhe 1(‘është e sigurt’). Indeksi i përfituar merr vlera nga 0 në 1, ku sa më afër 0 të rezultojë vlera e indeksit, aq më e vogël është mundësia për të marrë hua të re dhe, sa më afër 1-shit, aq më e lartë mundësia për të marrë hua të re në 6 muajt e ardhshëm.

përgjigjur deklarojnë se zotërojnë në total 1486 prona të patundshme të llojeve të ndryshme ku: 91% e tyre (987 familje) zotërojnë "1-2 prona të patundshme" kryesisht të llojit "shtëpi banimi" ose kombinim i një shtëpie banimi dhe një prone tjetër si "tokë", "dyqan", "godinë" etj. Kjo peshë ka shënuar rënie respektivisht me 1 pp krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe krahasuar me një vit më parë (Grafik 4.1). Nga ana tjetër, 3% deklarojnë se zotërojnë "më shumë se 2 prona të patundshme" (shtëpi dhe tokë/dyqan etj.), ndërsa 6% kanë deklaruar se "nuk zotërojnë asnjë pronë".


Duke e fokusuar analizën vetëm në grupin e **familjeve huamarrëse** (gjithsej 275 familje huamarrëse), rezulton se këto familje deklarojnë gjithsej 382 prona të patundshme, ku 68% e tyre janë "shtëpi", 28% janë "toka" dhe pjesa tjetër janë "dyqane", "godina" dhe lloje të tjera pronash.

Në shpërndarjen e familjeve huamarrëse sipas numrit të pronave që zotërojnë, rezulton se: rreth 93% e tyre (256 familje) zotërojnë "1-2 prona të patundshme" në momentin e intervistimit, dhe kjo peshë është rritur me 1 pp krahasuar me vrojtimin e kaluar dhe me 2 pp krahasuar me një vit më parë. Në shumicën e rasteve, këto prona janë një shtëpi banimi ose kombinimi i një shtëpie dhe një sipërfaqeje toke. Vetëm 1% e familjeve huamarrëse (4 familje) deklarojnë se zotërojnë "më shumë se dy prona", ndërkohë që rreth 5% e familjeve huamarrëse (15 familje) kanë deklaruar se "nuk zotërojnë asnjë pronë" (Grafik 4.2).

**Grafik 4.1 Shpërndarja e familjeve (total kampioni) sipas numrit të pronave që zotërojnë (në % ndaj totalit të familjeve që janë përgjigjur)**



**Grafik 4.2 Shpërndarja e familjeve huamarrëse sipas numrit të pronave që zotërojnë (në % ndaj totalit të familjeve që janë përgjigjur)**




Burimi: Banka e Shqipërisë.

**4.2 Pasuritë financiare të familjeve<sup>11</sup>**. Nga përgjigjet e dhëna lidhur me zotërimin e pasurive financiare nga familjet, rezulton se për periudhën e vrojtuar, 22% e totalit të kampionit të vrojtuar (familje huamarrëse dhe johuamarrëse) dhe 32% e grupit të familjeve huamarrëse "nuk zotërojnë asnjë lloj pasurie financiare". Të dyja këto pesha kanë rënë ndjeshëm krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar (me 46 pp) dhe krahasuar me një vit më parë (me 34 pp).

Duke analizuar vetëm pjesën e familjeve që kanë deklaruar pasuri financiare të formave të ndryshme (përfshirë rastet që "nuk kanë asnjë lloj pasurie financiare"), rezulton se "depozitat dhe/ose llogaritë bankare" vijojnë të mbeten lloji kryesor i investimit financiar, si në rastin e totalit të kampionit të familjeve (71% e rasteve të raportuara) dhe në rastin e familjeve huamarrëse (79% e rasteve të raportuara). Gjatë periudhës së vrojtuar, këto pesha janë rritur ndjeshëm, respektivisht me 14 pp për totalin e kampionit, dhe me 28 pp në rastin e familjeve huamarrëse. Rritja e normave të interesit në vend gjatë periudhës, duke se ka sjellë dhe rritje të depozitave të familjeve.


<sup>11</sup> Pyetjes mbi pasuritë financiare në pronësi të familjeve të intervistuar i janë përgjigjur 1088 familje.

**Grafik 4.3 Shpërndarja e familjeve (total kampioni) sipas llojit të pasurisë financiare (në % ndaj totalit të rasteve të deklaruara)**



Burimi: Banka e Shqipërisë.

**Grafik 4.4 Shpërndarja e familjeve huamarrëse sipas llojit të pasurisë financiare (në % ndaj totalit të rasteve të deklaruara)**



Përdorimi i formave të tjera të investimit, të përmbledhura në zërin "investime të tjera"<sup>12</sup>, ka rezultuar në rënie krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar, respektivisht me 8 pp në rastin e totalit të kampionit të vrojtuar dhe me 7 pp në rastin e grupit të familjeve huamarrëse.

<sup>12</sup> Në zërin "Investime të tjera" përmblihen rastet e investimeve në: bono thesari, sigurim jete, fond pensioni privat dhe aksione.